KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d.

09 -11- 2026

Nr. 8041

PRISHTINË - A

KEK KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2024 dhe Plotësim ndryshimit te UA 03/2024 për rregullimin e konkursit në sektorin publik, bazuar në Kodin e Punës nr. 804 të datës 28.01.2025 të KEK sha, si dhe nevojave emergjente të paraqitura për plotësimin e vendeve të lira të punës në Divizionin e KEK-ut, Kryeshefi Ekzekutiv i KEK-ut më 09.11.2026 autorizon Drejtorin e Burimeve Njerëzore qe të publikojë konkursin për pozitat e mëposhtme:

KONKURS

Titulli i pozitës:	**Skelar**
Institucioni:	Korporata Energjetike e Kosovës (Divizioni i TCA)
Numri i referencës:	15-09.11.2026
Tipi Akt Emërimit te punës:	Sipas Ligjit të punës 03/L-2012, UA01/2024, plotësim ndryUA03/2024 dhe Kodit të Punës së KEK-ut
Titulli i mbikëqyrësit	I raporton Prijësit të ekipit, inxhinierit të kryerjes dhe udhëheqësve të drejtpërdrejtë,
Kohëzgjatja e kontratës:	1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj.
Koeficienti-paga:	796 euro
Procedura e aplikimit:	I jashtëm
Numri i kërkuar:	**2**
Vendi i punës	Obiliq (TCA)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Bartësi i vendit te punës kryen montimin dhe demontimin e skeleve, Mirëmbajta e pajisjeve te TC "Kosova A" .I raporton Prijësit të ekipit, inxhinierit të kryerjes dhe udhëheqësve të drejtpërdrejtë. Bashkëpunon me te gjithë eproret e grupeve tjera të TC "Kosova A"Implementon realizimin e urdhëresave te punës për montimin e skeleve sipas urdhëresave dhe udhëzimeve tekniko – teknologjike te dhëna nga inxhinierët përgjegjës. Kryerjen e punëve sipas standardeve për montimin e skeleve. Respektimi rigoroz i udhëzimeve për montimin e skeleve, te cilat janë përgatitura nga inxhinieri përgjegjës.Ti përgjigjet në çdo kohe thirrjes për intervenim dhe te vazhdoj punën sipas nevojës edhe pas orarit të rregullt të punës.Zbaton te gjitha rregullat e sigurisë. Respekton orarin e punës me përkushtim dhe disiplinë.Kryen punët e dhëna nga prijësi i ekipit apo ndonjë epror tjetër ne sistemin ku është caktuar te punojë. Kryen edhe pune tjera me kërkesën e eproreve te tij. Është i autorizuar të kërkojë të gjitha provizionet te përcaktuara në kontratën e tij/saj. Te kërkojë ndihmë nga prijësi i ekipit apo inxhinieri i kryerjes ne vendin ku punohet.

Kërkesat profesionale/Kualifikimet

Përgatitja e mesme shkollore.
Së paku 3 (tri) vite përvojë pune me skele, e cila mund te dëshmohet me kontratë pune , vërtetim apo trust mbi përvojën e punes.
Aftësi profesionale, Aftësi që të arrijë afate kohore, Aftësi për pune ekipore.

Dokumetet qe duhet te dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit te tyre:

Gjatëa plikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe te plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese:

- **Aplikacionin-CV**-në e shkarkuar nga web faqja e KEK-ut eplotësoni, pas plotësimit duhet të ngarkohet në formën e aplikimit online te vegëza: "**Ngarko Aplikacionin-CV-në e plotësuar**".
- Dëshmia për kualifikimin tuaj: Diplomën e shkollës së mesme e skanoni ne një dokument të vetëm (formati .pdf ose .docx **ose .doc, madhësia maksimale 5 MB**) dhe pastaj e ngarkoni në aplikimin online tevegëza "**Ngarko dëshmitë e kualifikimit".**
- Pervojen e punës e dëshmoni me Kontrate pune apo vërtetim apo trust dhe e ngarkoni ne vegzen "**Ngarko deshminë e përvojës se punës".**

Nëse diploma është e fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës se fituar apo aktin qe dëshmon se diploma e fituar.

Mënyra e aplikimit

Aplikimi është online, ngarkoni dokumentet sipas kërkesave në konkurs. Aplikimi juaj është i kompletuar vetem nese e merrni e-malin konfirmues. Për çdo paqartësi dhe për siguri në aplikim kontaktoni në numrin e telefonit: 038 501-401-2671, por mund të shkruani edhe në e-mailin (ofertapune@kek-energy.com) për të vërtetuar aplikimin tuaj (vetem nese nuk keni pranuar e-malin konfirmues).

Njoftimi me rezultatin e konkursit publik

Kandidatët do të njoftohen individualisht me rezultatin e këtij konkursi duke e respektuar Udhëzimin Administrativ nr. 01/2024, plotësim ndryshimin e UA 03/2024 dhe Kodin e punës nr. 804 te datës 28.01.2025 për rregullimin e konkursit në sektorin publik.

Mënyra e vlerësimit të aplikantëve/kandidatëve:

Testimi praktik – ndërtimi i skeleve ne vendpunishte te TCA, vlerësohet deri ne shtatdhjete (70) pikë,
CV e kandidatit vlerësohet deri tridhjet (30) pikë,
Testimi prakitik do te mbahet ne hapësirat punuese te TC-ve ne ndërtimin e skeleve ne zonat e kaldajës se avullit.

KEK-u fton të gjithë të interesuarit, personat e guximshem qe nuk frikohen nga lartësia, të aplikojnë për pozitat e publikuara.

Në rast të pikëve të barabarta në fund të testimit përparësi do të kenë kandidatët nga komuna e Obiliqit dhe zonat tjera të rrezikuara konform ligjit nr. 05/l-044.

Vërejtje: Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes si në vijim: **Nëse nuk e deklaroni që anëtari i familjes së ngushtë ju punon në KEK, ne cilëndo fazë që vërtetohet aplikacionet-CV-të e juaja do të refuzohen. Asnjë Aplikacion dhe dokumentacion i dorëzuar pas afatit nuk do të merret në shqyrtim nga Komisioni i Ankesave, ndërsa ato të mangëta ose që nuk janë ne formatin e kërkuar më lartë do të refuzohen.**

Kandidatët e suksesshëm do të sistemohen në pozitën për të cilën kanë aplikuar sipas kësaj shpalljeje.

Kalendari i përafërt: brenda 25 dite testi praktik, brenda 25 dite intervistat me gojë dhe njoftimi final brenda 30 dite, nëse nuk ka ankesa të cilat e pezullojnë afatin e paraparë sipas UA01/2024.

Data e aplikimit deri më 24.11.2026 ora 24:00
Prishtinë, 09.11.2026

Divizioni i Burimeve Njerëzore

KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS sh.a. - KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C. - KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d.
KEK
PRISHTINË-A